L I G J
Nr.9139, datë 16.10.2003

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË POLONISË PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E MBROJTJES"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Polonisë për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3995, datë 6.11.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË POLONISË LIDHUR ME BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E MBROJTJES

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Polonisë, tani e në vazhdim të njohura si "Palë":

duke pasur parasysh se bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes është një element jetësor për sigurinë dhe stabilitetin dhe i një rëndësie të veçantë për bashkëpunimin në reformimin, vendosjen dhe përmirësimin e sistemit të sigurisë në botë;

duke pranuar rolin themelor të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, që tani e në vazhdim e njohur si NATO, në sigurimin e paqes dhe të sigurisë kombëtare;

duke vënë theksin mbi nevojën për të zhvilluar bashkëpunim të gjithanshëm, duke përfshirë rritjen e saj të mëtejshme në fushën e mbrojtjes, meqenëse Republika e Polonisë është bërë anëtare e NATO-s, mbështet politikën e "Dyerve të hapura" dhe përpjekjet e Republikës së Shqipërisë për t'u bashkuar në NATO dhe në strukturat europiane,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Qëllimi dhe subjekti i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje do të përcaktojë dispozitat bazë lidhur me bashkëpunimin ushtarak ndërmjet Palëve, bazuar në parimet e barazisë, partneritetit dhe përfitimit reciprok.

2. Bashkëpunimi ndërmjet Palëve brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje do të realizohet në përputhje me kompetencat e tyre, ligjet e tyre kombëtare, parimet dhe normat e njohura të ligjeve ndërkombëtare dhe angazhimet ndërkombëtare të Republikës së Polonisë dhe të Republikës së

Shqipërisë.

3. Bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes do të zhvillohet në fushat dhe format e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje:

1. "Bashkëpunim" do të thotë bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes.

2. "Personel ushtarak" nënkupton përfaqësues të forcave të armatosura të Shteteve Palë.

3. "Personel civil" nënkupton punonjësit civilë të forcave të armatosura të Shteteve Palë.

4. "Pala dërguese" nënkupton Palën e cila dërgon personelin e saj në territorin e shtetit të Palës tjetër, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

5. "Pala pritëse" nënkupton Palën që pret personelin e Palës dërguese në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3
Fushat e bashkëpunimit

1. Bashkëpunimi ndërmjet Palëve mund të përfshijë fushat e mëposhtme:

1) shkëmbimin e eksperiencave në fushën e planizimit ushtarak dhe të mbrojtjes në shtetet e të dyja Palëve;

2) funksionimin e forcave të armatosura në shoqëri demokratike, duke përfshirë zbatimin e dispozitave të traktateve ndërkombëtare në fushat e mbrojtjes, sigurisë dhe armëkontrollit;

3) pjesëmarrjen në veprimtari të programit të "Partneritetit për paqe", misioneve humanitare dhe paqeruajtëse, si dhe operacione të tjera të organizatave ndërkombëtare lidhur me mbështetjen e paqes dhe luftën kundër terrorizmit;

4) organizimin e forcave të armatosura, strukturës së njësive ushtarake dhe mbështetjes logjistike, administrimin dhe menaxhimin e personelit;

5) arsimimin ushtarak dhe trajnimin e personelit ushtarak, duke përfshirë aplikimin e mjeteve teknike moderne në arsimin dhe procesin e trajnimit;

6) çështjet që lidhen me shkëmbimin e informacionit të klasifikuar;

7) veprimtari të shërbimeve kërkimore dhe shkencore;

8) shkenca dhe studime ushtarake;

9) hidrologjinë, meteorologjinë dhe oqeanografinë ushtarake;

10) mbështetjen në zhvillimin e armatimit dhe pajisjeve ushtarake, duke përfshirë dispozitat e armatimit modern dhe pajisjeve ushtarake të forcave të armatosura të shteteve të të dyja Palëve, duke vendosur rregulla, zhvillim dhe kërkim ushtarak, mirëmbajtje dhe kontroll të armatimit dhe pajisjeve;

11) aspekte teknike të modernizimit të armatimit dhe pajisjet ushtarake me të cilat forcat e armatosura të Shteteve Palë janë të pajisura;

12) aplikimin e sistemeve të informacionit, teknologjive të informacionit dhe komunikimit të forcave të armatosura të shteteve të të dyja Palëve;

13) mjekësinë ushtarake;

14) çështje ligjore në fushën e mbrojtjes;

15) historinë ushtarake dhe muzeume;

16) veprimtari kulturore dhe sportive;

17) shkëmbime pushimesh dhe turizmi;

2. Çështjet specifike që lidhen me bashkëpunimin në fushat e përmendura më lart dhe në fusha të tjera të mbështetura në mënyrë reciproke mund të përcaktohen përmes marrëveshjeve të veçanta dhe protokolleve shtesë të miratuara midis njësive të organizmave përkatëse dhe ndërmjetësve të Palëve.

Neni 4
Ndjekja e zbatimit të Marrëveshjes

Organet për koordinimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e Marrëveshjes janë:

- në emër të Palës polake: Ministri i Mbrojtjes Kombëtare, Ministri i Ekonomisë dhe i Politikave Sociale;
- në emër të Palës shqiptare: Ministri i Mbrojtjes.

Neni 5
Format e bashkëpunimit

1. Bashkëpunimi ndërmjet Palëve do të kryhet në format e mëposhtme:

1) takime të ministrave të mbrojtjes, shefave të shtabit të përgjithshëm, shefave të forcave tokësore, të forcave ajrore dhe detare, si dhe të zyrtarëve të tjerë të ministrive të mbrojtjes dhe të forcave të armatosura të shteteve dhe Palëve;

2) shkëmbime eksperiencash midis ekspertëve;

3) konsultime politiko-ushtarake, konferenca dhe seminare;

4) takime midis delegacioneve të shtabeve të përgjithshme dhe të mbrojtjes, me qëllim shkëmbimin e informacionit për zhvillimin e forcave të armatosura të shteteve të Palëve dhe përcaktimin e kërkesave të bashkëpunimit;

5) studime dhe trajnime praktike në akademitë e larta ushtarake dhe institucionet kërkimore shkencore ushtarake, shkëmbime leksionesh dhe trajnuesish në fusha të ndryshme;

6) këshillime ekspertësh dhe asistencë, veçanërisht në vendosjen e rregullave, kërkim dhe zhvillim, kontroll i imtësishëm dhe ripërtëritje të armatimit dhe të pajisjeve për nevojat e forcave të armatosura;

7) vizita të anijeve në porte;

8) pjesëmarrje vëzhguesish në stërvitje ushtarake;

9) pjesëmarrje në misione paqeruajtëse dhe operacionet humanitare;

10) shkëmbim informacioni dhe dokumentacioni e materiale trajnuese;

11) organizim dhe pjesëmarrje në ngjarje kulturore dhe sportive.

2. Ministrat e shteteve të Palëve do të mbajnë konsultime për çështje të interesit reciprok, në rast nevoje.

3. Ministrat e mbrojtjes të shteteve të Palëve, gjithashtu, mund të autorizojnë trupa të tjerë vartës të tyre për të ruajtur kontaktet dhe për të zbatuar dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6
Planet e bashkëpunimit vjetor

1. Baza e bashkëpunimit për një vit të caktuar është plani vjetor i bashkëpunimit i pranuar në mënyrë reciproke.

2. Paraqitja dhe propozimet e planit vjetor të bashkëpunimit do të bëhen më 1 tetor të vitit paraardhës me vitin për të cilin është përgatitur plani.

3. Plani vjetor i bashkëpunimit miratohet dhe firmoset nga përfaqësuesit e autorizuar të Palëve më 1 dhjetor të vitit paraardhës me vitin për të cilin është përgatitur plani.

4. Plani vjetor i bashkëpunimit do të specifikojë detyra të veçanta, format e tyre, datat, vendet dhe numrin e pjesëmarrësve, si dhe autoritetet kompetente të Palëve.

5. Planet e miratuara vjetore të bashkëpunimit mund të përmirësohen me konsensus reciprok të Palëve.

Neni 7
Statusi i forcave dhe i personelit civil

Statusi i forcave dhe i personelit civil të shteteve Palë gjatë prezencës së tyre në territorin e shtetit të Palës tjetër, me qëllim pjesëmarrjen në aktivitete brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje, trajtohet nga dispozitat e Marrëveshjes ndërmjet Shteteve Palë të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në partneritetin për paqe, lidhur me statusin e forcave të tyre dhe

protokollin e tij shtesë, i bërë në Bruksel, më 19 qershor 1995.

Neni 8

Ruajtja e informacionit të klasifikuar

1. "Informacion i klasifikuar" nënkupton informacionin i cili, pavarësisht nga forma e shprehjes së tij, duke përfshirë gjendjen e përpunimit të tij, kërkon mbrojtje ndaj një shpërndarjeje të paautorizuar.

2. Informacioni i klasifikuar, i referuar në paragrafin 1, do të thotë saktësisht në përmbajtjen e tij informacion me nivel klasifikimi sigurie, në përputhje me legjislacionin kombëtar të secilës nga Palët.

3. Palët parashikojnë që nivelet e mëposhtme të klasifikimit korrespondojnë plotësisht me njëri-tjetrin.

Republika e Polonisë	Republika e Shqipërisë	Ekuivalenti në anglisht
ZASTRZEZONE	-------	RESTRICTED
POUFNE	KONFIDENCIAL	CONFIDENTIAL
TAJNE	SEKRET	SECRET
SCISLE TAJNE	TEPËR SEKRET	TOP SECRET

4. Mbi bazën e legjislacionit të shteteve të tyre, Palët do të zbatojnë çdo masë që synon mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të marrë sipas termave të kësaj Marrëveshjeje, nga Pala tjetër ose që ka nisur në referencë të një kontrate me Palën tjetër, ku kërkohet futja në informacion të klasifikuar. Ata do të sigurojnë për këtë informacion të paktën të njëjtën mbrojtje siç kërkohet për informacionin e tyre të klasifikuar me nivel të përcaktuar të klasifikimit të sigurisë.

5. Informacioni i klasifikuar, i shkëmbyer sipas termave të kësaj Marrëveshjeje, do të përdoret në mënyrë ekskluzive në përputhje me qëllimin për të cilin është transferuar.

6. Informacioni i përmendur në paragrafin 5 nuk do t'u bëhet i pranishëm nga Palët personave të tretë pa konsensusin paraprak të organeve të caktuara ose të një personi të autorizuar të Palës, i cili ka bërë klasifikimin e informacionit.

7. Informacioni i klasifikuar, i shkëmbyer sipas termave të kësaj Marrëveshjeje, mund t'u bëhet i pranishëm vetëm atyre personave, detyra e të cilëve kërkon marrjen e tij dhe kanë qenë të autorizuar për marrjen e këtij informacioni pas pastërtisë së nevojshme të sigurisë. Kleranca e sigurisë do të trajtohet në mënyrë të barabartë si kleranca e sigurisë, që kryhet për dhënie aksesi në informacionin kombëtar të klasifikuar, në përputhje me nivelin e caktuar të klasifikimit.

8. Informacioni i klasifikuar kryhet nga korrierët diplomatikë dhe ushtarakë. Një organ i përshtatshëm konfirmon marrjen e informacionit të klasifikuar dhe e transferon atë në përputhje me legjislacionin kombëtar që ka të bëjë me mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

9. Në qoftë se njëra nga Palët merr njohuri për dalje të paautorizuar të informacionit të klasifikuar të Palës tjetër, ajo menjëherë do të njoftojë këtë Palë rreth këtij fakti. Thyerjet e ligjeve dhe rregulloreve për mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar do të investigohen dhe ndiqen ligjërisht nga organet shtetërore të Palës mbi territorin e shtetit, në të cilin ndodhi thyerja e ligjit. Kjo Palë do të njoftojë Palën tjetër sa më shpejt të jetë e mundur mbi rezultatet e investigimit të marrë.

10. Çdo informacion i klasifikuar, i shkëmbyer midis Palëve brenda termave të kësaj Marrëveshjeje, do të mbrohet nga Palët sipas legjislacionit të shtetit të tyre pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje.

11. Organet përgjegjëse për mbrojtjen e shkëmbimit të informacionit të klasifikuar lidhur me çështjet e mbrojtjes janë:

- në emër të Palës polake: Shefi i Shërbimit Informativ Ushtarak;
- në emër të Palës shqiptare: Shefi i Shërbimit Informativ Ushtarak.

Neni 9

Financimi i bashkëpunimit

1. Financimi i veprimtarive bashkëpunuese do të kryhet në përputhje me parimet e mëposhtme:

1) Pala dërguese do të mbulojë si më poshtë:

a) shpenzimet e udhëtimit vajtje-ardhje në territorin e Palës pritëse;

b) shpenzimet e sigurimit të personelit të kërkuar, duke përfshirë sigurimin shëndetësor dhe ndaj dëmtimeve;

c) dokumentet e kërkuara nga autoritetet e shtetit të Palës pritëse të nevojshme për të hyrë dhe për t'u larguar nga territori i tij.

2) Pala pritëse do të mbulojë si më poshtë:

a) shpenzimet e ushqimit dhe akomodimit;

b) shpenzimet e transportit brenda programit të vizitës.

2. Pala pritëse në rast emergjence do të sigurojë shërbimin mjekësor dhe dentar të personelit civil dhe ushtarak të Palës dërguese. Pala dërguese do t'i rimbursojë Palës pritëse shpenzimet e këtij shërbimi brenda 30 ditësh nga marrja e faturës.

3. Palët mund të bien dakord për parime të tjera financiare, veç atyre të përmendura në paragrafin 1 nëpërmjet marrëveshjeve të veçanta dhe protokolleve shtesë.

4. Marrëveshjet financiare që lidhen me studimet në institucionet e arsimimit ushtarak ose akademitë ushtarake, si dhe ato që lidhen me zhvillimin e stërvitjeve ushtarake, trajnimeve ose operacioneve paqeruajtëse do të përcaktohen në një marrëveshje të veçantë.

Neni 10

Dispozitat përfundimtare

1. Kjo Marrëveshje i nënshtrohet pranimit nga Palët në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar, rreth të cilit Palët do të njoftojnë njëra-tjetrën. Marrëveshja do të hyjë në fuqi 30 ditë pas datës së marrjes së njoftimit të fundit.

2. Kjo Marrëveshje është përfundimtare për një periudhë kohe të pacaktuar. Ajo mund të denoncohet nga të dyja Palët përmes njoftimit. Në këtë rast, kjo Marrëveshje do të përfundojë 6 muaj nga data e marrjes së njoftimit.

3. Kjo Marrëveshje mund të përmirësohet në çdo kohë përmes një paraqitjeje me shkrim të Palëve.

4. Mosmarrëveshjet ndërmjet Palëve, lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhen ekskluzivisht nga Palët përmes konsultimeve.

Bërë në Varshavë, më 18 korrik 2003 në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.